



Qendra "Konsumatori Shqiptar"  
L. 11, Rr. Kumini, Pall. 1319 Durrës,  
Albania

3006 Prot.  
datë 28.10.2025

29.10.2025

Durrës, më 10.10.2025

## KËRKESË PËR INFORMACION

**Drejtuar:** Z. Besmir Veli,  
Kryetar,  
Bashkia Delvinë

**Përgatitur nga:** Qendra "Konsumatori Shqiptar"

**Objekti:** Kërkesë për informacion në lidhje me Zyrën e Mbrojtjes së Konsumatorëve pranë Bashkisë

**I nderuar Z. Veli!**

Ju urojmë të jeni mirë me shëndet dhe punë. Ju urojmë suksese në punën tuaj.

Qendra "Konsumatori Shqiptar" është një organizatë jofitimprurëse e krijuar në 2014 dhe ka si qëllim kryesor mbrojtjen dhe mbështetjen e konsumatorëve shqiptarë. Qendra është një nga organizatat e licensuara nga Ministria e Drejtësisë për ofrimin e ndihmës juridike parësore falas. Aktualisht, Qendra po zbaton projektin **SAFECons** - "Shoqëria Civile në Veprim për përpjekje të koordinuara për Sigurinë Ushqimore dhe Mbrojtjen e Konsumatorit" së bashku me ANTTARC, me mbështetjen e Bashkimit Evropian.

Një nga aktivitetet kryesore është monitorimi dhe nxitja e njësisive të vetëqeverisjes vendore në lidhje me **Zyrat për Mbrojtjen e Konsumatorëve (ZMK)**, në përputhje me Ligjin nr. 130/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, si dhe Ligjin nr.9902, datë 17.04.2008 "Për Mbrojtjen e Konsumatorëve", i ndryshuar.

Për sa më sipër, në përputhje me Ligjin nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", i ndryshuar, ju lutem na informoni në lidhje me:

1. A është ngritur dhe funksionon pranë Bashkisë Zyra për Mbrojtjen e Konsumatorëve? Nëse po, ju lutemi bashkëngjisni vendimin përkatës të Këshillit Bashkiak. Cili është viti që është krijuar kjo strukturë?
2. Cila është struktura përkatëse e ZMK-së në institucionin tuaj? Ju lutem bashkëngjisni organigramën ose aktin përkatës.
3. Cilat janë funksionet, detyrat dhe përgjegjësitë e ZMK-së ose nënpunësit përkatës? Ju lutem bashkëngjisni rregulloren ose aktin përkatës.
4. Cili është formimi arsimor i nënpunësit ose stafit të kësaj strukture? A janë trajnuar personat përgjegjës? Nëse po, çfarë trajnimesh kanë kryer? Ju lutem bashkëngjisni dokumentacionin përkatës.

5. Cilat janë aktivitetet që ka realizuar kjo strukturë në kuadër të mbrojtjes së konsumatorëve? Ju lutem bashkëngjisni ndonjë foto, ose link.



Qendra "Konsumatori Shqiptar"  
L. 11, Rr. Kumini, Pall. 1319 Durrës,  
Albania


6. A keni trajtuar ankesa nga konsumatorët? Nëse po, cila është procedura e trajtimit dhe ndjekjes së këtyre ankesave? A keni një formular ose rregullore të miratuar? Nëse po, Ju lutem bashkëngjisni dokumentat respektivë.
7. A keni dijeni për detyrimin për raportim në lidhje për mbrojtjen e konsumatorëve në kuadër të procesit të integritetit? A është caktuar personi përgjegjës? Nëse po, Ju lutem bashkëngjisni dokumentat respektivë.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin tuaj, jemi në pritje të përgjigjes suaj.

Për lehtësi komunikimi:  
Email: [qksh@qksh.org](mailto:qksh@qksh.org)  
Cel: 068 948 3303

Me respekt,  
Prof. As. Dr. Ersidë Teliti

Drejtoreshë Ekzekutive,  
Qendra "Konsumatori Shqiptar"



Përshëndetje të nderuar,

Në vijim të e-mailit të dërguar në dt. 10-11 Tetor 2025, nga Qendra “Konsumatori Shqiptar” me adresë [qksh@qksh.org](mailto:qksh@qksh.org), “Kërkesë për Informacion” (të cilën e gjeni bashkëngjitur). Do t’ju luteshim që në përputhje me legjislacionin për të drejtën e informimit, të na ktheni përgjigje brenda kësaj jave. Në rast të mungesës së përgjigjes nga ana juaj, do i drejtohem Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për marrjen e këtij informacioni.

Ju urojmë javë të mbare.

Me respekt,  
Qendra “Konsumatori Shqiptar”

29.10.2025

**Re: FW: KUJTESË NË LIDHJE ME KËRKESËN PËR INFORMACION**



**From** <info@bashkiadelvine.gov.al>

**To** <qksh@qksh.org>

**Date** 2025-10-29 08:57



Përshëndetje,

Në përgjigje të shkresës tuaj ,drejtuar Bashkisë Delvinë datë 10.10.2025 me objekt:" Kërkesë për informacion në lidhje me Zyrën e Mbrojtjes së Konsumatorëve pranë Bashkisë" po ju vëmë në dijeni se: Bashkia Delvinë nuk ka person të dedikuar për ZMK ose Zyrë për Mbrojtjen e Konsumatorit,por me rishikimin e strukturës të re do te shikohet mundësia e krijimit të saj nëse Bashkia me buxhetin e ardhshëm do të ketë mundësi financiare për këtë seksion.

Faleminderit

Bashkia Delvinë.

## Fwd: KUJTESË NË LIDHJE ME KËRKESËN PËR INFORMACION

From <info@bashkiadelvine.gov.al>  
To Ersisr8 <ersisr8@gmail.com>  
Date 2025-10-29 08:32

 Kerkese per informacion, Bashkia Delvine-1.pdf(~216 KB)

----- Original Message -----

Subject: FW: KUJTESË NË LIDHJE ME KËRKESËN PËR INFORMACION

Date: 2025-10-29 07:59

From: "qksh@qksh.org" <qksh@qksh.org>

To: <info@bashkiadelvine.gov.al>, <dorinamyftari@bashkiadelvine.gov.al>

Përshëndetje,

Në vijim të e-mailit dërguar më datë 11/10/2025 për "Kërkesë për informacion në lidhje me Zyrën e Mbrojtjes së Konsumatorëve pranë Bashkisë", në përputhje me ligjin për të drejtën e informimit, jemi në pritje të përgjigjes suaj, duke respektuar afatet e kërkuara nga ligji në fuqi.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

Ju urojmë gjithë të mirat.

Me respekt,

Qendra "Konsumatori Shqiptar"

From: qksh@qksh.org <qksh@qksh.org>

Date: Saturday, 11. October 2025 at 16:15

To: dorinamyftari@bashkiadelvine.gov.al

<dorinamyftari@bashkiadelvine.gov.al>

Cc: Kejs <kejsdule@outlook.com>

Subject: Kerkese per informacion ne lidhje me Zyren per Mbrojtjen e Konsumatoreve

Pershendetje!

Ju urojme te jeni mire me shendet dhe pune.

Bashkengjitur gjeni nje kerkese per informacion ne lidhje me Zyren per Mbrojtjen e Konsumatoreve ne Bashkine tuaj.

Duke ju falenderuar per kohen tuaj, ju urojme gjithe te mirat!

Me konsiderate

Qendra "Konsumatori Shqiptar"